

FTESË

Konventa për Integrimin Europian Grupi i Punës III (Bujqësia dhe Siguria Ushqimore)

**Sesioni 1, Tema: Siguria ushqimore dhe standardet e kërkuara
në kuadër të integritimit europian për Shqipërinë**

9 dhjetor 2020, ora 13:00-14:30

Platforma ZOOM

Link: <https://us02web.zoom.us/j/88266944740?pwd=Q3N4UjJoTDBmdUVNVjNwY3pNbmg5dz09>

Meeting ID: 882 6694 4740

Passcode: Emaconv

Lëvizja Europiane në Shqipëri (EMA), Kuvendi i Shqipërisë dhe Sekretariati Teknik i Këshilli Kombëtar të Integritimit Europian (KKIE) në partneritet me Slovak Foreign Policy Association, me mbështetjen financiare të SlovakAid, kanë kënaqësinë t'ju ftojnë në Sesionin 1 të Grupit të Punës III me temë *“Siguria ushqimore dhe standardet e kërkuara në kuadër të integritimit europian për Shqipërinë”*.

Me qëllim krijimin e urës së bashkëpunimit mes institucioneve shtetërore dhe shoqërisë civile e njëkohësisht forcimin e kapaciteteve në të dy sektorët, rikthehet Konventa për Integrimin Europian 2019-2021, zbatuar nga Lëvizja Europiane në Shqipëri në bashkëpunim me Ministrinë e Linjës dhe institucione të tjera shtetërore pas zhvillimit të suksesshëm të saj në periudhën 2014-2016. **Konventa për Integrimin Europian** përfaqëson një iniciativë që ka si qëllim të institucionalizojë debatin publik lidhur me çështjet e Bashkimit Europian, bazuar në partneritetin mes qeverisë dhe institucioneve publike, shoqërisë civile si dhe organizatave të biznesit; të forcojë aftësitë e ekspertëve në negociatat lidhur me Integrimin Europian; si dhe të transferojë eksperiencën sllovaqe në fushën e ndërtimit të institucioneve demokratike dhe dialogut të përhershëm profesional.

Fillimisht, ky model unik është aplikuar dhe zhvilluar me sukses nga Slovak Foreign Policy Association gjatë vitit 2003-2007 e më pas implementuar në Serbi, B&H, Mal të Zi, Maqedoni e Veriut. Në kuadër të Konventës në Shqipëri, janë ngritur Grupe Pune sipas kapitujve të negociatave me BE: (GP I: Gjqësori dhe të Drejtat Themelore (Kapitulli 23); GP II: Drejtësia, Liria, Siguria (Kapitulli 24); GP III: Bujqësia dhe Siguria Ushqimore (Kapitulli 11&12); GP IV: Fondet Strukturore (Kapitulli 22).

Grupi i Punës III, falë përvojës së ekspertëve, do të shqyrtojë e do të diskutojë tema në fushën e bujqësisë, zhvillimit rural dhe sigurisë ushqimore duke parashikuar një proces të mëtejshëm të reformës dhe pranimit në BE me fokus kapitujt e Acquis të BE - Kapitulli 11 dhe Kapitulli 12. Në këtë Grup Pune do të organizohen katër Sesionet. Këto sesione janë planifikuar të bashkë-kryesohen nga përfaqësues të *institucioneve shtetërore dhe shoqëri civile* dhe ekspertë të brendshëm të Konventës.

Në **sesionin 1** të Grupit I të Punës zhvilluar në bashkëpunim me **Kuvendin e Shqipërisë dhe Sekretariatit Teknik të Këshillit Kombëtar të Integritimit Europian (KKIE)** është përzgjedhur për diskutim **siguria ushqimore në Shqipëri, sfidat për arritjen e standardeve dhe politikat e ndërmarrja**, si dhe nevoja për bashkëpunim mes aktorëve shtetërore dhe atyre jo-shtetërorë në këtë fushë. Ky sesion synon të nxjerrë rekomandime dhe sugjerime në lidhje me temën e përzgjedhur dhe çështje që lidhen me kornizën ligjore; kapacitetin institucional dhe trajtimin e çështjeve. Aktiviteti do të zhvillohet online me anë të platformës ZOOM. Ju lutemi konfirmoni në info@em-al.org, pjesëmarrjen tuaj **deri më 8 dhjetor, ora 16:00** në mënyrë që të merrni pjesë në këtë aktivitet.

**Gjatë prezantimeve të ekspertëve do të ofrohet përkthim i njëkohshëm*

PROGRAMI

Grupi i Punës III (Bujqësia dhe Siguria Ushqimore)

Sesioni 1, Tema: Siguria ushqimore dhe standardet e kërkuara
në kuadër të integritimit europian për Shqipërinë

9 dhjetor 2020, ora 13:00-14:30

Platforma ZOOM

Link: <https://us02web.zoom.us/j/88266944740?pwd=O3N4UjJoTDBmdUVNVjNwY3pNbmg5dz09>

Meeting ID: 882 6694 4740

Passcode: Emaconv

12:40-13:00 Regjistrimi i pjesëmarrësve dhe udhëzime mbi përdorimin e platformës online

13:00-13:05 Hapje e aktivitetit

Z. Gledis Gjipali, Drejtor Ekzekutiv i Lëvizjes Europiane në Shqipëri

13:05-13:15 Roli i Kuvendit në fushën e sigurisë ushqimore

*E ftuar
nderi:* Znj. Vasilika Hysi, Nënkryetare e Kuvendit të Shqipërisë si dhe anëtare e Këshillit Kombëtar të Integritimit Europian

13:15-13:20 Roli i Këshillit Kombëtar për Integritimin Europian

Znj. Elda Zenelaj, Drejtore e Sekretariatit teknik të KKIE

13:20-13:45 Siguria ushqimore dhe standardet europiane: vlerësim i situatës në Shqipëri

Z. Florian Xhafa, Ekspert i brendshëm i Konventës për Grupin e Punës III

Z. Agim Rrapaj, Kryetar i Këshillit të Agrobiznesit Shqiptar (KASH)

13:45-14:00 Siguria ushqimore dhe standardet europiane: situata në Sllovaki dhe mësimet e nxjerra

Z. Matej Struhar, eksperti sllovak mbi sigurinë ushqimore – GP III

14:00-14:25 Diskutim i hapur

-Diskutim dhe komente nga përfaqësues të bizneseve, shoqëri civile, shoqatat e mbrojtjes së konsumatorit, ekspertë të fushës, universitete

- Nxjerrje e përfundimeve dhe rekomandimeve

14:30 Mbyllja e takimit